

**SHPALLJE VETEM PËR NËPUNËS CIVIL,
PËR PROCEDURËN E KONKURIMIT KOMBËTAR****Drejtor I Drejtorisë së Ekonomisë dhe Financës****Kategoria e pagës II-b**

Në zbatim të nenit 26 të Ligjit Nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, si dhe të Kreut II dhe III, të Vendimit Nr. 242, datë 18/03/2015, të Këshillit të Ministrave, Institucioni Bashkia Dimal shpall procedurën e konkurimit të hapur:

- **Drejtor I Drejtorisë së Ekonomisë dhe Financës**
- **Kategoria e pages II-b**

Pozicionet më sipër, u ofrohen fillimisht nëpunësve civilë të së njëjtës kategori për procedurën e lëvizjes paralele! Vetëm në rast se nga këto pozicione, në përfundim të procedurës së lëvizjes paralele, rezulton se ende ka pozicione vakante, ato janë të vlefshme për konkurimin nëpërmjet procedurës së ngritjes në detyrë dhe pranimit nga jashtë shërbimit civil për kategorinë e mesme drejtuese.

Për të dy procedurat (lëvizje paralele, ngritje në detyrë në kategorinë e mesme drejtuese) aplikohet në të njëjtën kohë!

Afati për dorëzimin e dokumentave për

LEVIZJE PARALELE:

26.11.2021

Afati për dorëzimin e dokumentave për

NGRITJE NË DETYRE

01.12.2021

Përshkrimi përgjithësues i punës për pozicionin si më sipër është:

1. Drejton, organizon dhe koordinon punën e kësaj drejtorie në bazë të planeve mujore dhe vjetore.
2. Garantimin i titullarit para miratimit të shkresave/urdhëresave me karakter financiar, lidhur me ligjshmërinë, rregullshmërinë dhe repektimin e parimeve të ekonomicitetit, efikasitetit dhe efektivitetit.
3. Përgatitja e dokumentit përfundimtar të buxhetit, bashkërendimi i punës gjatë gjithë procesit të përgatitjes së buxhetit për vitin ushtrimor, projek- buxhetin për vitin pasardhës dhe e paraqet për miratim në këshillin e bashkisë.
4. Monitoron zbatimin e buxhetit në Bashki dhe Njësitë Administrative të vartësisë në përputhje me Vendimin nr.54 dt. 24.12.2019 “Për miratimin e buxhetit të vitit 2020. Raportimi periodik para NA dhe të deleguarit të tij.
5. Përgatit analizën gjashtëmujore dhe vjetore të treguesve ekonomiko-financiare të bashkisë.
6. Përgatit materialet për në këshillin bashkiak për ndryshimet në buxhet për problemet që dalin gjatë vitit, gjatë zbatimit të buxhetit.
7. Pranimin ose jo të dokumentacionit, bazuar në kontrole pas faktit, në përputhje me kërkesat e legjislacionit në fuqi. Kryerjen saktë të trasaksioneve financiare në përputhje me rregullat e vendosura nga Ministria e Financave.
8. Mbikqyrja dhe menaxhimi efektiv i punonjësve të drejtorisë, ruajtja dhe ngritja e nivelit të tyre profesional, përmes analizave, seminareve, trajnimeve, interpretimeve shkresore të akteve normative, ligjore e nënligjore.
9. Në bazë të udhëzimeve për buxhetin dërgon në institucionet qendrore (ministritë e linjës), Prefekurën e Qarkut çdo muaj, evidencën e realizimit të shpenzimeve e të ardhurave, investimeve, si dhe për funksionet e deleguara.
10. Garantimin e mbledhjes së të gjitha borxheve të paarkëtuara dhe në rastet kur nuk është i mundur të mbledhet ky borxh, të dokumentohet që janë bërë përpjekjet për mbledhjen e tij, me përjashtim të rasteve kur përgjegjësia rregullohet me ligj të veçantë.
11. Garantimin që të gjithë kreditorët të paguhen në kohë, dhe rast ankesash për mospagesë në kohë, të shpjegojë rrethanat para nëpunësit autorizues ose të deleguarit të tij.
12. Drejton e organizon punën për mbylljen e pasqyrave financiare të bashkisë në përputhje me rregullat e miratuar sipas afateve të përcaktuara nga M.F.
13. Ndjek problemet operative dhe bëhet pjesë e zgjidhjes së tyre.
14. Në përputhje me Manualin për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin, miratuar me urdhërin nr. 8980 datë 15.07.2010 të Ministrit të Financave, ngarkohet me detyrën e koordinatorit të Riskut, të koordinojë punën me drejtoritë e tjera, në të cilin është identifikuar dhe vlerësuar risqet e mundshme.

1.1 KUSHTET DHE KRITERET E VEÇANTA

LËVIZJA PARALELE

Kanë të drejtë të aplikojnë për këtë procedurë vetëm nëpunësit civilë të së

njëjtës kategori, në të gjitha insitucionet pjesë e shërbimit civil.

KUSHTET PËR LËVIZJEN PARALELE DHE KRITERET E VEÇANTA

Kandidatët duhet të plotësojnë kushtet për lëvizjen paralele si vijon:

- a- Të jetë nëpunës civil i konfirmuar, brenda së njëjtës kategori;
- b- Të mos ketë masë disiplinore në fuqi;
- c- Të ketë të paktën vlerësimin e fundit “mirë” apo “shumë mire”;

Kandidatët duhet të plotësojnë kërkesat e posaçme si vijon:

- a) Të zotërojnë diplomë “Master Shkencor në fushën Ekonomike” *Diplomat të cilat janë marrë jashtë vendit, duhet të jenë të njohura paraprakisht pranë institucionit përgjegjës për njehsimin e diplomave sipas legjislacionit në fuqi*
- b) Përvoja e punës përbën avantazh.

1.2 DOKUMENTACIONI, MËNYRA DHE AFATI I DORËZIMIT

Kandidatët që aplikojnë duhet të dorëzojnë dokumentet si më poshtë:

- a- Jetëshkrim i plotësuar në përputhje me dokumentin tip që e gjeni në linkun: <http://dap.gov.al/vende-vakante/udhezime-dokumenta/219-udhezime-dokumenta>
- b- Fotokopje të diplomës (përfshirë edhe diplomën bachelor);
- c- Fotokopje të librezës së punës (të gjitha faqet që vërtetojnë eksperiencën në punë);
- d- Fotokopje të letërnjoftimit (ID);
- e- Vërtetim të gjendjes shëndetësore;
- f- Vetëdeklarim të gjendjes gjyqësore.
- g- Vlerësimin e fundit nga eprori direkt;
- h- Vërtetim nga Institucioni që nuk ka masë disiplinore në fuqi.
- i- Çdo dokumentacion tjetër që vërteton trajnimet, kualifikimet, arsimin shtesë, vlerësimet pozitive apo të tjera të përmendura në jetëshkrimin tuaj;

Dokumentet duhet të dorëzohen me postë apo drejtpërsëdrejti në institucion, brenda datës 26 nëntor 2021

1.3 REZULTATET PËR FAZËN E VERIFIKIMIT PARAPRAK

Brenda datës 28 nëntor 2021, njësia e menaxhimit të burimeve njerëzore të Institucionit Bashkia Dimal ku ndodhet pozicioni për të cilin ju dëshironi të aplikoni do të shpallë në portalin “Shërbimi Kombëtar i Punësimit” listën e kandidatëve që plotësojnë kushtet dhe kriteret e veçanta, si dhe datën, vendin dhe orën e saktë ku do të zhvillohet intervista.

Në të njëjtën datë kandidatët që nuk i plotësojnë kushtet dhe kriteret e veçanta do të njoftohen individualisht nga njësia e menaxhimit të burimeve njerëzore të institucionit ku ndodhet pozicioni për të cilin ju dëshironi të aplikoni, nëpërmjet adresës tuaj të e-mail, për shkaqet e moskualifikimit.

1.4

FUSHAT E NJOHURIVE, AFTËSITË DHE CILËSITË MBI TË CILAT DO TË ZHVILLOHET INTERVISTA

Kandidatët do të vlerësohen në lidhje me:

- a) Njohuritë mbi Ligjin 139/2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore”
- b) Njohuritë mbi Ligjin Nr. 152/2013, “Për Nëpunësin Civil”, i ndryshuar, si dhe aktet ligjore dhe nënligjore dalë në zbatim të tij.
- c) Njohuritë mbi Ligjin Nr. 9131, datë 08.09.2003, “Për rregullat e etikës në administratën publike”.
- d) Njohuritë mbi Ligjin Nr. 8503, datë 30.06.1999, “Për të drejtën e informimit për dokumentet zyrtare”, i ndryshuar.
- e) Njohuritë mbi Ligjin Nr. 44/20151 “Kodi I Procedurave Administrative I Republikës Së Shqipërisë” I ndryshuar
- f) Ligjin Nr. 9936 dt.26.06.2008 “Për menaxhimin e buxhetit në Republikën e Shqipërisë”,
- g) Ligjin Nr. 10 296 date 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”.
- h) Ligjin 7661 dt.19.01.1993 “Per kontabilitetin”.
- i) Udhëzimin e Ministrit të Financave nr.2 date 06.02.2012 “Per procedurat standarte te zbatimit të buxhetit”,
- j) Udhëzimin e Ministrit të Financave nr. 30 date 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, i ndryshuar.
- k) Udhëzimin e Ministrit të Financave nr. 33 date 11.07.2013 “Për gjurmet standarte te auditit për prokurimin me vlerë të vogël dhe të lartë,
- l) V.K.M. nr. 248 dt.10.04.1998 ‘Për miratimin e planit kontabël të organeve të pushtetit lokal institucionet shtetëore e lokale si dhe njësive qe varen prej tyre ’, i ndryshuar, me V.K.M. nr. 25 dt.20.01.2001.

MËNYRA E VLERËSIMIT TË KANDIDATËVE

Kandidatët do të vlerësohen në lidhje me dokumentacionin e dorëzuar:

Kandidatët do të vlerësohen për pervojen, trajnimet apo kualifikimet e lidhura me fushën, si dhe certifikimin pozitiv. Totali i pikëve për këtë vlerësim është 40 pikë.

Kandidatët gjatë intervistës së strukturuar me gojë do të vlerësohen në lidhje me:

- a- Njohuritë, aftësitë, kompetencën në lidhje me përshkrimin e pozicionit të punës;
- b- Eksperiencën e tyre të mëparshme;
- c- Motivimin, aspiratat dhe pritshmëritë e tyre për karrierën.

Totali i pikëve për këtë vlerësim është 60 pikë.

Më shumë detaje në lidhje me vlerësimin me pikë, metodologjinë e shpërndarjes së pikëve, mënyrën e llogaritjes së rezultatit përfundimtar i gjeni në Udhëzimin nr. 2, datë 27.03.2015, të Departamentit të Administratës Publike “ëëë.dap.gov.al”

<http://dap.gov.al/2014-03-21-12-52-44/udhezime/426-udhezim-nr-2-date-27-03-2015>

DATA E DALJES SË REZULTATEVE TË KONKURIMIT DHE MËNYRA E KOMUNIKIMIT

Në përfundim të vlerësimit të kandidatëve, informacioni për fituesin do të shpallet në faqen zyrtare të bashkisë si dhe në portalin “Shërbimi Kombëtar i Punësimit”.

2. NGRITJE NË DETYRË KATEGORINË E MESME DREJTUESE

Vetëm në rast se nga pozicionet e renditura në fillim të kësaj shpalljeje, në përfundim të procedurës së lëvizjes paralele, rezulton se ende ka pozicione vakante, këto pozicione janë të vlefshme për konkurimin nëpërmjet procedurës ngritjes në detyrë për kategorinë e Mesme Drejtuese.

KUSHTET QË DUHET TË PLOTËSOJË KANDIDATI NË PROCEDURËN E NGRITJES NË DETYRË PËR KATEGORINË E MESME DREJTUESE

KRITERET E VEÇANTA

Kanë të drejtë të aplikojnë për këtë procedurë vetëm nëpunësit civilë të një kategorie më të ulët, në të gjitha insitucionet pjesë e shërbimit civil.

Kushtet që duhet të plotësojë kandidati për ngritje në detyrë janë:

- a) Të jetë nëpunës civil i konfirmuar, brenda kategorisë së kërkuar;
- b) Të mos ketë masë disiplinore në fuqi;
- c) Të ketë të paktën vlerësimin e fundit “mirë” apo “shumë mire”;

Kandidatët duhet të plotësojnë kërkesat e posaçme si vijon:

- a) Të zotërojnë diplomë “Master Shkencor në fushën Ekonomike” *Diplomat të cilat janë marrë jashtë vendit, duhet të jenë të njohura paraprakisht pranë institucionit përgjegjës për njehsimin e diplomave sipas legjislacionit në fuqi*
- b) Përvoja e punës përbën avantazh.

DOKUMENTACIONI, MËNYRA DHE AFATI I DORËZIMIT

Kandidatët që aplikojnë duhet të dorëzojnë dokumentat si më poshtë:

- a- Jetëshkrim i plotësuar në përputhje me dokumentin tip që e gjeni në linkun:
<http://dap.gov.al/vende-vakante/udhezime-Dokumente/219-udhezime-Dokumente>
- b- Fotokopje të diplomës (përfshirë edhe diplomën bachelor);
- c- Fotokopje të librezës së punës (të gjitha faqet që vërtetojnë eksperiencën në punë);
- d- Fotokopje të letërnjoftimit (ID);
- e- Vërtetim të gjëndjes shëndetësore;
- f- Vetëdeklarim të gjëndjes gjyqësore;
- g- Vlerësimin e fundit nga eprori direkt;
- h- Vërtetim nga Institucioni që nuk ka masë disiplinore në fuqi;
- i- Çdo dokumentacion tjetër që vërteton trajnimet, kualifikimet, arsimim shtesë, vlerësimet pozitive apo të tjera të përmendura në jetëshkrimin tuaj.

Aplikimi dhe dorëzimi i të gjitha dokumentave të cituara më sipër, do të bëhen pranë zyrës së protokollit Bashkia Dimal ose me postë Brenda datës 1 dhjetor 2021

REZULTATET PËR FAZËN E VERIFIKIMIT PARAPRAK

Deri në datën 11 dhjetor 2021, njësia përgjegjëse do të shpallë në faqen zyrtare të internetit dhe në portalin “Shërbimi Kombëtar i Punësimit”, listat e kandidatëve që plotësojnë kushtet dhe kërkesat e posaçme për procedurën e ngritjes në detyrë në kategorinë e Mesme Drejtuese, si dhe datën, vendin dhe orën e saktë ku do të zhvillohet testimi me shkrim dhe intervista.

Në të njëjtën date kandidatët që nuk i plotësojnë kushtet e pranimit në kategorinë e mesme drejtuese dhe kriteret e veçanta do të njoftohen individualisht në mënyrë elektronike nga njësia përgjegjëse, për shkaqet e moskualifikimit (*nëpërmjet adresës së e-mail*).

FUSHAT E NJOHURIVE, AFTËSITË DHE CILËSITË MBI TË CILAT DO TË ZHVILLOHET TESTIMI ME SHKRIM DHE INTERVISTA

Kandidatët do të testohen me shkrim në lidhje me:

- a) Njohuritë mbi Ligjin 139/2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore”
- b) Njohuritë mbi Ligjin Nr. 152/2013, “Për Nëpunësin Civil”, i ndryshuar, si dhe aktet lighore dhe nënligjore dalë në zbatim të tij.
- c) Njohuritë mbi Ligjin Nr. 9131, datë 08.09.2003, “Për rregullat e etikës në administratën publike”.
- d) Njohuritë mbi Ligjin Nr. 8503, datë 30.06.1999, “Për të drejtën e informimit për dokumentet zyrtare”, i ndryshuar.
- e) Njohuritë mbi Ligjin Nr. 44/20151 “Kodi I Procedurave Administrative I Republikës Së Shqipërisë” I ndryshuar
- f) Ligjin Nr. 9936 dt.26.06.2008 “Për menaxhimin e buxhetit në Republikën e Shqipërisë”,
- g) Ligjin Nr. 10 296 date 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”.
- h) Ligjin 7661 dt.19.01.1993 “Per kontabilitetin”.
- i) Udhëzimin e Ministrit të Financave nr.2 date 06.02.2012 “Per procedurat standarte te zbatimit të buxhetit”,

- j) Udhëzimin e Ministrit të Financave nr. 30 date 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, i ndryshuar.
- k) Udhëzimin e Ministrit të Financave nr. 33 date 11.07.2013 “Për gjurmet standarte te auditit për prokurimin me vlerë të vogël dhe të lartë,
- l) V.K.M. nr. 248 dt.10.04.1998 ‘Për miratimin e planit kontabël të organeve të pushtetit lokal institucionet shtetëore e lokale si dhe njësitë që varen prej tyre ’, i ndryshuar, me V.K.M. nr. 25 dt.20.01.2001.

Kandidatët gjatë intervistës së strukturuar me gojë do të vlerësohen në lidhje me:

- a- Njohuritë, aftësitë, kompetencën në lidhje me përshkrimin përgjithësues të punës për pozicionet;
- b- Eksperiencën e tyre të mëparshme;
- c- Motivimin, aspiratat dhe pritshmëritë e tyre për karrierën.

MËNYRA E VLERËSIMIT TË KANDIDATËVE Kandidatët do të vlerësohen në lidhje me:

- a- Vlerësimin me shkrim, deri në 40 pikë;
- b- Intervistën e strukturuar me gojë që konsiston në motivimin, aspiratat dhe pritshmëritë e tyre për karrierën, deri në 40 pikë;
- c- Jetëshkrimin, që konsiston në vlerësimin e arsimimit, të përvojës e të trajnimeve, të lidhura me fushën, deri në 20 pikë.

Më shumë detaje në lidhje me vlerësimin me pikë, metodologjinë e shpërndarjes së pikëve, mënyrën e llogaritjes së rezultatit përfundimtar i gjeni në Udhëzimin nr. 2, datë 27.03.2015, të Departamentit të Administratës Publike “ëëë.dap.gov.al”

<http://dap.gov.al/2014-03-21-12-52-44/udhezime/426-udhezim-nr-2-date-27-03-2015>

DATA E DALJES SË REZULTATEVE TË KONKURIMIT DHE MËNYRA E KOMUNIKIMIT

Në përfundim të vlerësimit të kandidatëve, Njësia përgjegjëse në Bashkinë Dimal do të shpallë fituesin në faqen zyrtare dhe në portalin “Shërbimi Kombëtar i Punësimit”. Të gjithë kandidatët pjesëmarrës në këtë procedurë do të njoftohen individualisht në mënyrë elektronike për rezultatet (nëpërmjet adresës së e-mail).

Të gjithë kandidatët që aplikojnë për procedurën e ngritjes në detyrë për kategorinë e Mesme Drejtuese, do të marrin informacion në faqen e Bashkisë Dimal, për fazat e mëtejshme të procedurës së ngritjes në detyrë:

- për datën e daljes së rezultateve të verifikimit paraprak,
- datën, vendin dhe orën ku do të zhvillohet konkurimi;

Për të marrë këtë informacion, kandidatët duhet të vizitojnë në mënyrë të vazhdueshme faqen e Bashkisë Dimal si dhe Portali Kombëtar i Punësimit duke filluar nga data 1 dhjetor e në vijim.